



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

**Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health**  
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

<b>DATË/A:</b>	<b>11.01.2023</b>
<b>PËR/ZA/TO:</b>	<b>KIGA SH.P.K. z. Ismail Shabani</b>
<b>NGA/OD/FROM:</b>	<b>Berat Marmullaku, zv. Udhëheqës i Div. te Prokurimit</b>
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	<b>VENDIM, mbi rishqyrtimin e Kërkesë për Rishqyrtim</b>

I nderuar z. Shabani,

Autoriteti Kontraktues - Ministria e Shëndetësisë, ne bazë të nenit 108A (paragrafi 10.1) të Ligjit per Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe Rregulloren për Prokurimin publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të parashtruar nga Operatori Ekonomik KIGA SH.P.K. te datës 11.01.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit tenderit me titull: "Furnizim me material shpenzues medicinal nga LE" me nr. prokurimi 206-22-13832-1-1-1, nxjerr:

## V E N D I M

- I. **HEDHET POSHTË**, si jashtë afatshme Kërkesa për Rishqyrtim e OE KIGA SH.P.K. nga Fushë Kosova, e datës 11.01.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me material shpenzues medicinal nga LE" me nr. prokurimi 206-22-13832-1-1-1, kundër Njoftimit për kontratë te datës 05.12.2022, pasi që e njëjta është parashtruar jashtë afatit ligjor për rishqyrtim në Autoritetin Kontraktues.
- II. Ankesa e operatorit ekonomik ankues nuk mund të shqyrtohet, pasi që e njëjta është parashtruar jashtë afatit ligjor.
- III. AK - MSh, vazhdon me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me material shpenzues medicinal nga LE" me nr. prokurimi 206-22-13832-1-1-1.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks.gov.net>.

## **Pretendimi për Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues**

**Shkeljet e LPP-se nga ana e AK-së:**

Shkeljet:

Neni 1

Neni 7

Neni 59

Neni 60

Ne lidhje me aktivitetin e prokurimit 206-22-13832-111, Furnizim me material shpenzues medicinal nga LE, kemi hasur tek kriteret mungesen si ne gjithë tenderet e kaluar te AK-MSH "Mostrat" per produktet e ofertuara, ku edhe ne si Operator ekonomik ne bashkepunim me furnoret tane per cdo produkt kemi 2-3 lloje oferta dhe na duhet te deshmojme sakte se cilin produkt po e ofertojme, per tu vertetuar cilesia. A mund te rregullohet kjo si kerkese dhe te kerkohet edhe Mostra per produktet e ofertuara, pasi qe kjo eshte si kerkese e kompanise sone per te pasur edhe AK me te lehte vleresimin, pranimin e materialit sipas kontrates dhe produktit te ofertuar per te mos pasur manipulime gjate dorezimit.

---

## **ARSYETIM**

Operatori Ekonomik: KIGA SH.P.K. ka bërë kërkesë për ri-shqyrtim me date 11.01.2023. Afati i fundit per dorezim te tendereve eshte 16.01.2023.

### **Baza Ligjore për refuzim të Kërkesës për Ri-shqyrtim**

Ligji i Prokurimit Publik në bazë të nenit 108/A - Zgjidhja e mosmarrëveshjeve, para 3. i cili thekson:

*3. Kërkesa për shqyrtim duhet të dorëzohet tek autoriteti përkatës kontraktues, me postë ose me çdo mjet tjetër të komunikimit të lejuar me këtë ligj, brenda afateve të mëposhtme:*

*3.1 në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit brenda pesë (5) ditëve para afatit të fundit për dorëzim të ofertave;*

Operatori Ekonomik ankimor ka dorezuar Kerkesen per rishqyrtim me date 11.01.2023.

Duke u bazuar në dispozitat e nenit 108/a par.3 dhe 3.1. OE ankimor ka lëshuar afatin ligjor (ius strictum) për të parashtruar ankesë pasi që ka parashtruar ankesë kater para afatit te fundit per dorezim te ofertave.

### **Nenin 60.1(b) i Rregullave te prokurimit pubik**

*Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit se paku pesë (5) ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave. Në kalkulim të afateve kohore dita e dorëzimit të ofertave është dita (0). Ky afat nuk aplikohet në rastet kur AK bën zgjatje të afatit të fundit për dorëzim të ofertave pas vendimit për refuzim të kërkesës për rishqyrtim sipas Nenit 63.1.1 të kësaj rregullore.*

### *Nenin 63.2 i Rregullave te prokurimit pubik*

*Vendimi mbi refuzimin ose miratimin është obligativ dhe do të publikohet në sistem të prokurimit elektronik nga Zyrtari Përgjegjës i prokurimit. Në rastet kur zyrtari përgjegjës i prokurimit nuk nxjerrë vendim në lidhje me kërkesën për shqyrtim dhe nuk njofton operatorin ekonomik për afat shtesë, Operatori Ekonomik ka të drejte që të parashtror një ankese pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit pas skadimit të afatit prej 3 (tre) dite pune nga data e dorëzimit të kërkesës për rishqyrtim. Në kalkulim të afateve kohore data e dorëzimit të kërkesës për rishqyrtim është dita (0).*

Do te thote, data 11.01.2023, sipas 63.2 eshte dita (0), 12.01.2023 dita 1, 13.01.2023 dita 2, 14.01.2023 dita 3, 15.01.2023 dita 4 dhe 16.01.2023 eshte dita (0) ne perputhje me nenin 60.1(b).

AK hedh poshte ankesen e parashtrua ne perrputhje me nenin 108/a i LPP-se paragrafi 8.1 cili nen percakton se:

**Autoriteti kontraktues do ta refuzojë një kërkesë për rishqyrtim kur: 8.1 kërkesa nuk dorëzohet brenda afateve kohore të përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni.**

ZPP, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Këshille juridike:**

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të parashtror ankese pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohen brenda dhjetë (10) ditëve pas këtij vendimi.

### **Vendimi i dorëzohet:**

1. 1x1 OE KIGA SH.P.K.
2. 1x1 Operatoreve ekonomik te interesuar

Me respekt.